

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT  
 DHE SPORTIT  
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

## MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE 2025

Lënda: Qytetari dhe Psikologji

### Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim dhe arsyetim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7
Pikët							
Kërkesa	8	9	10	11	12	13	14
Pikët							
Kërkesa	15	16	17	18	19	20	21
Pikët							
Kërkesa	22	23	24	25	26	27	28
Pikët							
Kërkesa	29	30	31	32	33		
Pikët							

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

**Qytetari**

1. Kushtetuta është një përmbledhje e ligjeve themelore të një shteti. Në të përcaktohet edhe ndarja e kompetencave mes pushtetit qendror dhe atij lokal. Kjo lidhet me: **1 pikë**
- A) formën e shtetit.
  - B) sistemin gjyqësor.
  - C) organizimin shtetëror.
  - D) të drejtat e qytetarëve.
2. Në një sistem demokratik, populli e ushtron pushtetin e tij drejtpërdrejt ose përmes përfaqësuesve të tij. Ky parim kushtetues lidhet me: **1 pikë**
- A) sovranitetin.
  - B) shtetin ligjor.
  - C) barazinë para ligjit.
  - D) kushtetutshmërinë.
3. Rreziqet që u kanosen njerëzve në jetën e përditshme janë të shumta. Qëllimi i ligjit për të minimizuar këto rreziqe lidhet me funksionin e tij si: **1 pikë**
- A) përmirësues i jetës së njerëzve.
  - B) mjet për të sjellë ndryshime në shoqëri.
  - C) rregullator i marrëdhënieve mes shtetasve dhe shtetit.
  - D) parandalues i dëmeve materiale dhe konflikteve njerëzore.
4. Kodet janë një sërë rregullash e normash juridike që rregullojnë: **1 pikë**
- A) fusha të caktuara të jetës së vendit.
  - B) rendin në situata të jashtëzakonshme.
  - C) veprimtarinë e institucioneve shtetërore.
  - D) marrëdhëniet mes shteteve të ndryshme.
5. Të drejtat e njeriut janë të shumëllojshme. E drejta për të ushtruar gjuhën amtare është njëra prej tyre. Kjo e drejtë bën pjesë në kategorinë e të drejtave: **1 pikë**
- A) civile.
  - B) sociale.
  - C) politike.
  - D) kulturore.
6. Dardani është nxënës i ri në klasën e njëmbëdhjetë. Ai ndihet i vetmuar, pasi i mungon mbështetja e nxënësve të tjerë dhe për këtë arsye e ka të vështirë të realizojë punën në grup. Gjendja e tij lidhet me komponentin e shëndetit: **1 pikë**
- A) fizik.
  - B) social.
  - C) mendor.
  - D) okupacional.

7. Një përkufizim i termit “depistim” është: “Hetim mjekësor i cili nuk vjen si pasojë e kërkesës për ndihmë së një pacienti që ankohet nga një problem shëndetësor”. Mamografia dhe Pap testi bëjnë pjesë në këtë program. Ky parandalim lidhet me nivelin: **1 pikë**

- A) parësor.
- B) sekondar.
- C) terciar.
- D) kuaternar.

8. Në samitin e klimës COP28, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, i bëri thirrje komunitetit ndërkombëtar që të veprojnë dhe të përmbushin angazhimet e tyre për klimën. U bë thirrje për përsheptimin e përpjekjeve drejt reduktimit të të gjitha lëndëve djegëse fosile dhe për trefishim të kapacitetit të energjisë së rinovueshme globalisht.

Këto angazhime për klimën realizohen nëse shtetet do të respektojnë me prioritet:

**1 pikë**

- A) parimin “ndotësi paguan”.
- B) parimin e përgjegjësisë ligjore.
- C) procesin e riciklimit të plastikës.
- D) parimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

9. Tabela sinjalistike njofton një vendkalim këmbësorësh jo të rregulluar nga semafori.

Kjo tabelë bën pjesë në kategorinë e sinjaleve:

**1 pikë**

- A) horizontale.
- B) të rrezikut.
- C) vertikale, urdhëruese.
- D) vertikale, treguese.



10. Banorët kanë të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas ligjit për bashkëjetesën në komunitet. Një nga të drejtat e banorëve të një pallati është: **1 pikë**

- A) të respektojë normat e etikës dhe bashkëjetesës.
- B) të lejojë kryerjen e inspektimeve dhe riparimeve të pronës së përbashkët
- C) të informohet nga Asambleja për vendimet e marra në mungesë të tij.
- D) të zgjedhë, por jo të zgjidhet si anëtar i strukturave të pallatit.

11. Qeveria e një vendi ka ndërmarrë disa masa të përkohshme për të adresuar kërcënimet ndaj sulmeve terroriste. Në hapësirat publike janë vendosur kamera sigurie për të shtuar kontrollin dhe janë zgjeruar kompetencat për të monitoruar komunikimet elektronike me qëllim zbulimin dhe parandalimin e sulmeve. Në këto kushte disa qytetarë shprehen të shqetësuar për të drejtën e privatësisë. Gjithashtu për shkak të situatës janë shtuar kontrollet fizike në pikat kufitare, çka ka shkaktuar pakënaqësi ndër udhëtarët.

Vlerësoni tri argumente të cilat justifikojnë kufizimin e të drejtave për shembullin e mësipërm.

**3 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

12. "Shpresat për të ardhmen tonë nuk vijnë nga nevoja për pak më shumë teknologji apo Produkt të Brendshëm Bruto. Ato vijnë nga nevoja për më shumë njohuri, më shumë ndërgjegjësim, më shumë përgjegjësi individuale ndaj të mirës së përbashkët." - shprehej C. Rovelli.

Analizoni dy funksione që realizon shkolla në përmbushjen e nevojave që parashtron C. Rovelli.

**4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

13. Në industrinë konkurruese të produkteve për kujdesin e lëkurës, studiuesit e marketingut duhet të zhvillojnë një strategji gjithëpërfshirëse reklamimi. Ata synojnë të shmangin mashtrimet në reklamë dhe të sigurojnë një komunikim efektiv duke u fokusuar në funksionet kryesore të reklamës.

Shpjegoni tre funksione të reklamës që studiuesit e marketingut duhet të zbatojnë në këtë fushatë.

**3 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

14. "Emigrimi lidhet me mundësinë e zgjedhjes së lirë e vlerësimin e avantazheve vetjake dhe nuk është gjithmonë tregues i braktisjes së një vendi të pazhvilluar."

Argumentoni qëndrimin pro ose kundër lidhur me pohimin:

**2 pikë**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Vlerësoni një avantazh ose disavantazh të emigrimit për qëllime punësimi.

**1 pikë**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

15. Zhvillimi i shpejtë i medias dhe i teknologjisë së informimit dhe komunikimit, shoqërohet me avantazhe dhe disavantazhe për përdoruesit e medias.

Analizoni dy avantazhe dhe dy disavantazhe të informimit në ditët e sotme.

**4 pikë**

Avantazh

1) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

2) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Disavantazh

1) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

2) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

16. Edukimi bashkëmohatar është një praktikë shumë efektive, prandaj disa të rinj janë trajnuar për të qenë pjesë e një projekti mbi sigurinë rrugore. Ata do të realizojnë takime në disa shkolla të mesme për të promovuar respektimin e rregullave të qarkullimit dhe përdorimin e biçikletave.

Bazuar në qëllimin e projektit, cilat do të ishin tri rregullat që do të rekomandojnë të rinjtë për t'u ndjekur në qarkullimin me biçikletë?

**3 pikë**

1) \_\_\_\_\_

2) \_\_\_\_\_

3) \_\_\_\_\_

**Psikologji**

17. Në situata të caktuara, kur jemi të lumtur apo ndihemi të vlerësuar dhe të shpërblyer për përpjekjet e bëra, në trurin tonë prodhohet me shumicë: **1 pikë**
- A) insulinë.  
B) tiroksinë.  
C) kortizol.  
D) dopaminë.
18. Shpesh njerëzit përballen me sfida të ndryshme, të cilët i bëjnë ata të përjetojnë emocione të forta. Në këto raste, sistemi që aktivizohet dhe përgatit trupin tonë për aksion është sistemi: **1 pikë**
- A) somatik.  
B) qendror.  
C) simpatik.  
D) parasimpatik.
19. Valbona ka aplikuar në disa vende të lira për punësim, por nuk ka marrë përgjigje pozitive pas intervistave. Në këtë periudhë ajo ndihet e stresuar dhe ka një vetëvlerësim të ulët. Psikologu i drejtimit psikodinamik në takimet me Valbonën përqendrohet në: **1 pikë**
- A) eksplorimin e përvojave të mëparshme përmes asosacioneve të lira.  
B) ofrimin e trajnimeve për zhvillimin në karrierë dhe sugjerimeve për punë.  
C) identifikimin e modeleve negative të mendimit që lidhen me vetëvlerësimin e ulët.  
D) eksplorimin dhe zhvillimin e mënyrave më të përshtatshme për rritjen profesionale të saj.
20. Joni është në klasën e tetë. Ai është zgjedhur lider i ekipit të debatit. Juria e ka vlerësuar për qëndrimin që ai mban përballë këndvështrimeve të ndryshme dhe aftësinë argumentuese për temat komplekse nga aktualiteti. Sipas Piazhësë, në cilin stad të zhvillimit kognitiv ndodhet Joni? **1 pikë**
- A) Stadi sensore/motore.  
B) Stadi paraoperacional.  
C) Stadi operacional konkret.  
D) Stadi operacional formal.
21. Njerëzit e vetaktualizuar kanë qëndrim pozitiv ndaj jetës. Ata janë të ndërgjegjshëm dhe të lirë të gjejnë vetë rrugën e jetës, duke marrë edhe përgjegjësitë e tyre. Këto karakteristika të qenies njerëzore lidhen me shpjegimin e personalitetit sipas teorisë: **1 pikë**
- A) kognitive.  
B) humaniste.  
C) bihevjoriste.  
D) psikanaliste.
22. Albani punon si udhërrëfyes turistik në Parkun Kombëtar të Butrintit. Faktet historike që ai u prezanton vizitorëve, ruhen në kujtesën: **1 pikë**
- A) shqisore.  
B) episodike.  
C) semantike.  
D) afatshkurtër.

**23.** Shkrimtari W.H Auden në disa vepra u ndikua fuqishëm nga përvojat sfiduese të së shkuarës së tij në fëmijëri. Auden përjetoi pasiguritë e luftës, pasojat e trazirave politike, shoqërore, përgjatë viteve të formimit të tij, duke ndikuar kështu në temat poetike dhe eksplorimin e emocioneve njerëzore. Përcaktoni cila teori shpjegon motivimin e poetit në këtë rast. **1 pikë**

- A) Biologjike
- B) Frojdiste
- C) Humaniste
- D) Bihejviorist

**24.** Kamionët e kompanisë së transportit “L”, pothuajse gjithmonë marrin kthesat djathtas. Sipas përlogaritjeve logjistike vlerësohet se në këtë mënyrë kursehet karburant dhe shmangen emetimet në mjedis. Përcaktoni llojin e inteligjencës sipas teorisë së Gardnerit, për këtë situatë: **1 pikë**

- A) hapësinore.
- B) kinestetike.
- C) ndërpersonale.
- D) intrapersonale.

**25.** Gjatë diktaturës ushtarake në Argjentinën e viteve 1976-1983, shumë qytetarë raportuan tek autoritetet çdo perceptim për aktivitete antiqeveritare. Raportimi i qytetarëve pranë autoriteteve lidhet me: **1 pikë**

- A) empatinë.
- B) obediencën.
- C) inteligjencën emocionale.
- D) sjelljen jonormale.

**26.** Psikologu Asch realizoi një eksperiment me grupe prej 7 vetash. Ai iu tregoi dy figura, njëra kishte një vijë standarde, ndërsa e dyta tre vija vertikale me gjatësi të ndryshme. Subjektet duhet të gjenin vijën që ishte e njëjtë me gjatësinë e figurës së parë dhe duhet të jepnin përgjigjen me zë. U vu re se kur përgjigjeshin pa praninë e të tjerëve nuk gabonin. Ndërsa kur ishin në grup dhe i pari gabonte, 1/3 gabonin duke u ndikuar nga përgjigjja që jepte i pari. Ky ndikim social lidhet me: **1 pikë**



- A) obediencën.
- B) kompiancën.
- C) konformizmin.
- D) altruizmin.

**27.** Psikoanaliza është një drejtim psikologjik i themeluar nga Frojdi, në fund të shekullit të XIX. Përshkruani tre aspekte të mendjes njerëzore që përcaktojnë sjelljen sipas psikoanalizës. **3 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**28.** Shpjegoni burimin e stresit në situatat e mëposhtme: **2 pikë**

Në garën e 100 metërshit Kaltra doli e para. Trajneri i saj ka shumë besim se ajo mund të jetë fituesja e kampionatit të atletikës, ndaj po ndjek një disiplinë të rreptë në stërvitje. Kaltra ndihet e shqetësuar për të arritur synimin.

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Ana dhe Era kanë krijuar një biznes online. Tashmë që të ardhurat nga përfitimet online taten, fitimet e tyre kanë rënë. Vajzat po mendojnë të investojnë në fushën e agroturizmit, pasi e shohin më fitimprurës.

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**29.** Neuroni është një qelizë e specializuar të kryejë disa funksione. Përcaktoni tre funksionet që kryhen prej tij. **3 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_

**30.** Në jetën e përditshme për shkaqe të ndryshme që shpesh nuk varen nga ne, ndodh të na luhatet humori dhe për pasojë përjetojmë trishtim, pasiguri, frikë. Për të përmirësuar shëndetin mendor duhet të trajtojmë me kujdes emocionet tona. Analizoni tri mënyra për të ruajtur ekuilibrin emocional. **3 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_



31. Sipas Eriksonit, formimi i identitetit përgjatë adoleshencës ndikohet nga ndërveprimi me të tjerët, eksplorimi roleve, vetëreflektimi. Ky proces shoqërohet me konflikte të brendshme. Shpjegoni konfliktin e brendshëm, në raport me zhvillimin e identitetit personal dhe social. **4 pikë**

Identiteti personal \_\_\_\_\_

Identiteti social \_\_\_\_\_

32. Në një botë gjithnjë e më shumë digjitale, që ecën me ritme të shpejta, e me diversitet të lartë, marrëdhëniet njerëzore shpesh janë bërë sfiduese. Vlerësoni tri rrugë për të përmirësuar dhe humanizuar marrëdhëniet mes njerëzve: **3 pikë**

1) \_\_\_\_\_

2) \_\_\_\_\_

3) \_\_\_\_\_

33. Gjatë stadeve të ndryshme të gjumit, njerëzit shohin ëndrra dhe shpesh janë kureshtarë të dinë kuptimin e tyre. Ekzistojnë disa shpjegime për ëndrrat sipas psikologëve të ndryshëm. Përshkruani pikëpamjet e psikologëve të poshtëshënuar për shpjegimin e ëndrrave. **2 pikë**

Frojdi \_\_\_\_\_

Adler \_\_\_\_\_